



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit

P-011

Prishtinë, më 20 mars 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 20 MARS 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Eqrem Kryeziu, kurse munguan Ibrahim Gashi dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë më 10 e 11 mars 2008,
2. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për punën e Kryesisë së Kuvendit,
3. Shqyrtimi i Projekt- Rregullores për stafin politik,
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2007,

5. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e shpenzimeve të telefonisë (fiksë dhe mobile) dhe të bufësë.

7. Të ndryshme:

- 7.1. Kërkesa e anëtarit të Kryesisë, Slobotan Petroviq, për kompensimin e qerasë për banesë,
- 7.2. Kërkesa e katër kryetarëve të GP lidhur me sigurimin e veturave për punë të GP,
- 7.3. Kompensimi për truprojen e Kryetarit të Kuvendit, vozitësit e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit dhe të sekretarit të Kuvendit,
- 7.4. Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve ditore, në shumë prej 5 € për dy pjesëtarët e SHPK-së, të cilët janë në përcjellje dhe sigurim të Kryetarit të Kuvendit,
- 7.5. Shqyrtimi i kërkesës së Shërbimit Mjekësor për kompensimin jashtë orarit të përcaktuar me kontratë dhe kujdestarinë për ditët e seancave plenare.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtura më 10 e 11 mars 2008

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendi, të mbajtura më 10 e 11 mars 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projekt-Rregullore për punën e Kryesisë së Kuvendit

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë se Projektregulloren, me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, e ka hartuar Administrata e Kuvendit, në bashkëpunim me Projektin për Mbështetje të Mëtejme Kuvendit.

Kryesia, pasi shqyrtoi Projektregulloren, nen për nen, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja e Punës së Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që t'i inkorporojë vërejtjet e dhëna në tekstin e Projektregullore, që janë të evidencuara sipas transkriptit nga mbledhja e Kryesisë.

3. Shqyrtimi i Projekt- Rregullore për stafin politik

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë se Projektregulloren, me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, e ka hartuar Administrata e Kuvendit, në bashkëpunim me Projektin për Mbështetje të Mëtejme Kuvendit.

Kryesia, pasi shqyrtoi Projektregulloren, nen për nen, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohen Rregullat për punësimin e stafit politik në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që t'i inkorporojë vërejtjet e dhëna në tekstin e Projektregullave, që janë të evidencuara sipas transkriptit nga mbledhja e Kryesisë.

4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) për vitin 2007

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se AKK-ja, në bazë të nenit 18 të Ligjit Kundër Korrupsionit, ia ka paraqitur raportin njëvjeçar për miratim Kuvendit të Kosovës.

Kryesia, pas diskutimit të të gjithë anëtarëve të saj, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Komisioni për Buxhet e Financa dhe Komisioni për Punë të Brendshme e Siguri që ta shqyrtojë dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me Raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2007.

5. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se në bazë të nenit 19 të LKK-së, Agjencia Kundër Korrupsionit ka kërkuar nga Kuvendi që të emërojë përfaqësuesit e vet në cilësinë e anëtarëve në Këshillin e AKK-së.

Kryesia, pas diskutimit të të gjithë anëtarëve të saj, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Komisioni për Buxhet e Financa dhe Komisioni për Punë të Brendshme e Siguri që ta shqyrtojnë kërkesën për emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Kuvendit t'ia paraqesin propozimet për emërimin e kandidatëve nga Kuvendi i Kosovës për këtë Këshill.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e shpenzimeve të telefonisë (fikse dhe mobile) dhe të bufesë

Kryesia, pasi e diskutoi dhe e shqyrtoi propozim-vendimin për caktimin e shpenzimeve të telefonisë mori këtë

V E N D I M

Miratohet Vendimi për caktimin e shumës së shpenzimeve të telefonisë (fikse dhe celulare) dhe të bufesë për zyrtarët e Kuvendit, sipas propozimit nr. Nr. O3-V-021, datë 20.03.2008.

7. Të ndryshme:

7.1 Kërkesa e anëtarit të Kryesisë, Slobotan Petrović, për kompensimin e qirasë për banesë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e anëtarit të Kryesisë për kompensimin e qirasë për banesë, mori këtë

V e n d i m

1. Miratohet kërkesa e anëtarit të Kryesisë, Slobodan Petrović, për kompensimin e shpenzimeve të qirasë për banim në Prishtinë, në periudhën prej një viti, përkatësisht deri sa zgjatë mandati i tij.
2. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.

7.2 Kërkesa e katër kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me sigurimin e veturave për punë e tyre

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e katër kryetarëve të grupeve parlamentare, nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Të kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që Kuvendit të Kosovës t'ia ndajë-dhurojë 4 automjete për nevojat zyrtare të grupeve parlamentare,
2. Shpenzimet e karburanteve, të vozitësve dhe të mirëmbajtjes së veturave, barten nga buxheti i grupeve parlamentare,
3. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që ta zbatojë këtë përfundim.

7.3 Kompensimi për truprojnë e Kryetarit të Kuvendit, vozitësit e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit dhe të sekretarit të Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë mori

Vendim

Për caktimin e shumës për kompensim

1. Kompensohen ditët e punës gjatë vikendit për truprojnë e Kryetarit të Kuvendit, vozitësit e anëtarëve të Kryesisë dhe vozitësin e sekretarit të Kuvendit në shumë prej 100€.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit dhe shfuqizon çdo vendim tjetër që është në kundërshtim me të.
3. Ngarkohet Departamenti i Administratës së Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim

7.4 Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve ditore në shumë prej 5 € për dy pjesëtarë të SHPK-së, të cilët janë në përcjellje dhe sigurim të Kryetarit të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, mori

V e n d i m
Për caktimin e shumës për kompensim

1. Kompensohet në shumë ditore prej 5€ angazhimi i dy pjesëtarëve të SHPK-së në cilësinë e përcjellësve dhe sigurimin e Kryetarit të Kuvendit.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit dhe shfuqizon çdo vendim tjetër që është në kundërshtim me të.
3. Ngarkohet Departamenti i Administratës së Kuvendit, që të zbatojë këtë vendim

7.5 Shqyrtimi i kërkesës së Shërbimit mjekësor për kompensimin jashtë orarit të përcaktuar me kontratë dhe kujdestarinë për ditët e seancave plenare.

Kryesia, pasi shqyrtoi Shërbimit mjekësor, mori këtë

V e n d i m

1. Kompensohet në shumë ditore prej 5€ angazhimi i personelit shëndetësor për punë me të gjatë sesa koha e paraparë me kontratë dhe për kujdestari në ditët e mbajtjes së seancave plenare të Kuvendit të Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit dhe shfuqizon çdo vendim tjetër që është në kundërshtim me të.
3. Ngarkohet Departamenti i Administratës së Kuvendit, që të zbatojë këtë vendim.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12 : 45.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale